

**“POLITIKAT SOCIALE DHE MBROJTJA E FËMIJËVE TË
BRAKTISUR NË KOSOVË”**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SOCIOLOGJISË**

NGA

BESMIR KRASNIQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOG

PRISHTINË

KORRIK, 2021

REZYME

“TEMA: POLITIKAT SOCIALE DHE MBROJTJA E FËMIJËVE TË BRAKTISUR NË KOSOVË

”

Mentori:

Prof. Ass. Dr: FADIL MALOKU

Në ato rrethana kur nuk ekziston përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, autoriteti qendror ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Ndihma që ofrohet për këta njerëz është e dinjitetshme sepse ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në ligjet në Kosovë dhe Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut. Qendrat për Punë Sociale në Kosovë (QPS-të), janë institucione publike profesionale të qeverisura nga niveli komunal dhe të monitoruara nga niveli qendror, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë-MPMS e që kanë mandatin e mbrojtjes së banorëve në gjendje të nevojave sociale pa dallime gjinore, moshe, sociale, nacionale, fetare, etj. QPS-ja ofron shërbime sociale e familjare në emër të ministrisë së MPMS-së. Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare ”Qendra për Punë Sociale”, formon organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion, siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës si dhe shërbime tjera të parapara me ligj përveç shërbimëve sociale dhe familjare”.

Qendra është e obliguar që të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose familje që jeton dhe që gjendet në territorin e saj, e që ka nevojë për ndihmë ose shërbime sociale e familjare dhe adreson probleme dhe bashkëpunon ngusht me Organizatat Joqeveritare që thirren në fushën e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, duke filluar nga Koalicioni i Organizatave në Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë- KOMF, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, Organizata për Fëmijët pa Kujdesje Prindërore-OFAP dhe të tjera OJQ në fusha tjera në mbrojtjes se fëmijëve siç janë: strehimoret që strehojnë nënat dhe fëmijët në rast nevoje. Koalicioni i Organizatave për të drejtat e fëmijëve- KOMF Kosova, është duke realizuar fushatën mediale

“Komuna ime, e drejta ime sociale”. Nder të tjerash në këtë fushatë thuhet: “Shërbimet në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nuk janë të integruar në mes të sektorëve të shërbimeve sociale, arsimit dhe shëndetësisë. Mungesa e shërbimeve apo shërbimet e izoluar dhe të paintegruara bëjnë që familja të endet nëpër institucione të ndryshme për sigurimin e tyre. Andaj, është shumë e nevojshme të punohet për fuqizimin dhe integrimin e shërbimeve mes sektorit të shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore. Ofrimi i shërbimeve të integruara me familjen në qendër, do të mundësonte shërbime më cilësore duke përmbushur kështu të drejtat themelore të njeriut për jetë të dinjitetshme dhe mbrojtje sociale.”

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës- LIGJI NR.06/L-084 në Korrik të vitit 2019 dhe ky ligj është hyrë në fuqi prej datës 17 Korrik 2020. Andaj, respektimi i tij kërkohet nga të gjitha palët e interesit. Kur flasim për fëmijët rëndësia e posaçme është interesi më i lartë i fëmijës, i cili përmbushet, kur nevojat e zhvillimit fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes së tij/saj. Çdo përpjekje duhet bëhet që të promovohet mirëqenia e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike. Konventa e OKB-së, për të Drejtat e Fëmijës, thekson qartë se të gjithë fëmijëve pa kujdes prindëror, përfshirë fëmijët e braktisur, fëmijët me nevoja të veçanta dhe të keqtrajtuar duhet t’u mundësohet të jetojnë në familje.

Në këtë punim do të trajtohen çështje rreth identifikimit të shërbimeve sociale nga autoritetet qendrore, nga organizatat vendore dhe të huaja që kanë fokus sistemin e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdesje prindërore.

Për mbrojtjen e një fëmije të braktisur, shërbimet sociale janë të obliguara. Po ashtu duhet të zgjedhin formën më të përshtatshme për të mbrojtur më së miri interesin e fëmijës. Shërbimet sociale janë të obliguara që të shqyrtojnë të gjitha mundësitë, që fëmijëve pa përkujdesje prindërore, t’i mundësohet sa më shpejt që të jene pjesëtar i një familje. Vetëm në rastet kur kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të shihet mundësia e strehimit të përkohshëm rezidencial dhe strehimit alternativ.

Në të tre kapitujt e këtij punim trajtohen tema të rëndësishme, duke filluar nga elaborimet e ndryshme të shërbimeve që u ofrohen fëmijëve në fushën e mbrojtjes, krahasimet në disa nga

shtetet në Ballkan dhe tutje. Punimi është realizuar duke u bazuar në të dhënat e raportëve të ndryshme në Kosovë, të cilat paraqesin sfidat dhe përparësitë në fushën e mbrojtjes.

Qëllimi i punimit është analiza e politikave social, të cilat prekin fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindrore, analizimi i ligjit në fuqi për të drejtat e kësaj kategorie dhe konventat dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu trajtohet një analizë e gjendjes në ofrimin e shërbimëve institucionale për fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore.